

Buletini i radiove të huaja në
gjuhën shqipe

Nr.100

Tiranë, më 2 maj 1987

Radio "ZERI I AMERIKËS"

PESHËNGRITESI SHQIPTAR, ALEKSANDER KONDO, VDIQ SOT NË NJË AKSIDENT
MAKINE

Sot në moshën 27-vjeçare vdiq në një aksident automo-
bilistik, në qytetin e Nju -Jorkut, peshëngritësi shqiptar, i
ndjeri Aleksandër Kondo.

I ndjeri Aleksandër Kondo bashkë me një shokun e tij,
duke u kthyer nga garat që kishin bërë në Poloni, në vitin 1985
u zhdukën në një rrugë të Titogradit. Më vonë Beogradi njoftoi
se ata kishin kërkuar strehim politik dhe pastaj emigruan në
Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

I ndjeri Kondo do të varroset në varrezat e kishës or-
todokse shqiptare të Shën Nikollit, në Nju-Jork.

BISEDE ME NJË PROFESOR SHQIPTAR NË TIRANË

Organizata "Emnisti internejshëndëll", me seli në Lon-
dër, e cila merret me shqyrtimin e respektimit të të drejtave
të njeriut, ka akuzuar qeverinë shqiptare për shkeljen e të dre-
jtave elementare të njeriut, duke mohuar lirinë e ushtrimit të
besimit fetar dhe duke burgosur kundërshtarët e regjimit të rre-
ptë stalinist. Bashkëpunëtori i "Zërit të Amerikës", Frank Uil-
son, i cili bëri një udhëtim nëpër Shqipëri këto kohët e fundit,